



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

05.Nr. 294/17
Datë: 24.08.2017

Duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212, të Punës e në lidhje me Udhëzimin Administrativ nr. 17/2009 të datës 28.08.2009, Udhëzimit Administrativ nr. 06/2015-normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, vendimeve të MASHT-it Nr.225/01B, 214/01B si dhe Ref,Nr.1054 të Ministrisë së Financave të datës 21.08.2017, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Istog, shpall:

KONKURS

Për plotësim të vendit të punës.

Në SHFMU "Fan.S.Noli" Llukac i Begut

1. Një mësimdhënës/e për nivelin (1-5) zëvendësim deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

Dokumentacini i nevojshëm për aplikim

- Formulari i aplikimit(kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftimi),
- Certifikata e lindjes
- Diplomat e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës por jo më e vjetër se gjashtë muaj.Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk shqyrtohet,
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit,Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT(nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim(nëse ka).

Kushtet dhe kriteret e konkursit:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të rezultateve të intervistës dhe kriterëve që përcaktohen me udhëzimet administrative të MASHT-it : UA/nr.05/2015, UA/nr.06/2015 ,UA/ nr.10/2015 dhe Vendimet e MASHT.

- **Afati i konkursit**

Afati i konkursit mbetet i hapur deri më datën 04.09.2017.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra nr.100,kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin po në të njejten zyrë.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje,komisioni në rast dyshimi do të kërkoj origjinalin në intervistë. Pas përfundimit të procedurës së konkursit,dokumentacioni nuk kthehet as nuk ruhet.

Vërejtje: Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet. Gjithashtu për intervistë do të ftohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin e lartë cekur.

Me respekt !



Drejtori i DKA-së
Agim Haxhiu